

FEDERATA E KARATESË E KOSOVËS  
KOSOVO KARATE FEDERATION



RREGULLORE E PUNËS PËR KOMISIONIN E  
GJYQTARËVE

PRISHTINË 2021

- KREU I - DISPOZITAT E PËRGJITHSHME**
- KREU II - KOMPETENCAT DHE PËRGJEGJËSITË**
- KREU III - LICENCIMI DHE TITUJT E GJYQTARËVE**
- KREU IV - SEMINARET DHE PROVIMET PËR GJYQTARË**
- KREU V - KODI I SJELLJES**
- KREU VI - PËRZGJEDHJA DHE DELEGIMI I GJQYTARËVE**
- KREU VII - MEDITJET, PAGESAT DHE SHPËRBLIMET.**
- KREU VIII - RREGULLAT E PËRGJITHSHME**
- KREU IX - MASAT DICIPLINORE**
- KREU X - DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE**

*Çdo emërim, terminologji e përdorur në gjinin mashkullorë i takon dhe përfaqëson edhe gjinin femërorë si dhe anasjelltas!*

**KREU I  
DISPOZITAT E PËRGJITHSHME**

**Neni 1**

Kjo rregullore ka për qëllim rregullimin dhe sistematizimin e punës së komisionit të gjyqtarëve dhe të gjithë gjyqtarëve pranë Federatës të Karatesë së Kosovës dhe e njëjta mund të pësojë ndryshime, plotësime të propozuara nga komisioni i gjyqtarëve dhe me aprovim të Bordit Ekzekutiv të FKK-së.

#### **Neni 2**

Për të mirën e sportit të Karatesë, komisioni i gjyqtarëve (*tutje si KGJ*) do të siguroj që gjyqtarët e kualifikuar në nivel shtetëror dhe ndërkombëtarë me njohuri të mirë të rregullave dhe në përputhje me standardet ndërkombëtare do të jenë pjesëmarrës në garat që do të zhvillohen në Kosovë dhe jasht saj.

#### **Neni 3**

KGJ do të ofrojë mundësi për të gjithë të interesuarit pa dallim gjinie, race, etnie të jenë pjesë e gjyqtarisë pranë Federatës të Karatesë të Kosovës (*tutje si FKK*) dhe të marrin pjesë në gara, seminare, trajnime dhe provime për licencim brenda Kosovës dhe jasht saj.

#### **Neni 4**

Komisioni i gjyqtarëve do të zbatojë politikat e FKK-së në përgjithësi dhe të krijoj, ruaj dhe zbatoj rregulloren e komisionit të gjyqtarëve në veçanti duke bashkëpunuar me komisionet tjera relevante të FKK-së.

#### **Neni 5**

Të gjithë gjyqtarët detyrimisht duhet të bëjnë regjistrimin vjetor pranë Federatës të Karatesë së Kosovë përmes KGJ-së.

#### **Neni 6**

Komisioni i KGJ-së do të regjistrojë, protolojë dhe vulosë të gjitha dokumentet e komisionit të nënshkuara nga Kryesuesi i KGJ-së (*regjistrimi i gjyqtarëve, diplomat, licencat dhe librezat e lëshuara e etj*) në zyern e FKK-së dhe ato do të qëndrojnë dhe ruhen në zyrë të FKK-së. Kopjet tjera do të qëndrojnë në KGJ.

#### **Neni 7**

KGJ duhet të krijoj dhe mirëmbajë bazën e shënimeve për certifikimin, vlerësimin, titujt dhe regjistrimet e të gjithë gjyqtarëve të Kosovës me kualifikime shtetërore dhe ndërkombëtare të njëjtat duhet të regjistrohen (*protokolohen*) në librin amë sipas nenit 6 të kësaj rregulloreje.

#### **Neni 8**

KGJ duhet të lëshoj diploma për gjyqtarët e certifikuar me licenca shtetërore pranë FKK-së.

#### **Neni 9**

KGJ duhet të jetë i informuar në çdo kohë për ndryshimet e mundëshme të rregullores së garave dhe të informoj me kohë të gjithë gjyqtarët, si dhe herë pas here dhe sipas nevojës të zhvilloj takime me anëtarët e komisionit.

#### **Neni 10**

1. Komisioni i gjyqtarëve përbëhet nga 3 anëtar të rregullt me të drejtë vote dhe një sekretar teknik pa të drejtë vote. KGJ është në përbërje si vijon:

- 1.1 *Kryetari i Komisionit, i përzgjedhur nga Bordi Ekzekutiv i FKK-së me konksur të hapur;*
- 1.2 *2 (dy) anëtar të rregullt, të propozuar nga kryetari i komisionit të gjyqtarëve dhe të miratuar nga Bordi Ekzekutiv i FKK-së;*
- 1.3 *Sekretari teknik i komisionit, i propozuar dhe përzgjedhur nga komisioni i gjyqtarëve.*

#### **Neni 11**

Në rast të mos miratimit të anëtarëve të komisionit nga Bordi Ekzekutiv i FKK-së, kryesuesi duhet të propozojë emra të ri të anëtarëve.

#### **Kriteret e përzgjedhjes së Kryetarit të KGJ-së**

#### **Neni 12**

Kryetari i KGJ-së duhet të përmbushë kriteret në vijim:

1. Të ketë së paku nivelin më të ultë të mundshëm profesional të arsimit të lartë;
2. Diploma/Certifikata mbi Përgatitjen e tij/saj profesionale (së paku 2-DAN);
3. Jo më të rinjë se mosha 30 vjeçare;
4. Që nuk është suspenduar 5 vitet e fundit nga ndonjë komision legjitim;
5. që nuk i është nënshtruar ndonjë mase dicitpline pranë FKK-s në 3 vitet e fundit;
6. Nivel i certifikimit ndërkombëtar;
7. S'paku pesë (5) vite përvojë pune të pandërprerë në sportin e karatesë si refer i FKK-së;
8. Rezultate të theksuara në punën profesionale me komisionin e referëve të FKK-së;
9. Rezultate të theksuara në garat zyrtare kombëtare dhe ndërkombëtare;
10. Njohja e njëres nga gjuhët zyrtare të WKF-it (angleze, spanjolle dhe frenge) e obliguar;

#### **Neni 13**

Apliakacioni për kryesues të komisionit të gjyqtarëve duhet të përmbajë:

- Diploma arsimore
- Cv
- Diplomat/cetifikatat relevante (DAN)
- Certifikata për gjyqtar vendor/ndërkombtar
- Dëshmi për punën aktive në 5 vitet e fundit
- Dëshmi për rezultate e arritura
- Planin e punës me gjyqtar
- Planin katër vjeçar të punës si kryesues

#### **Neni 14**

Takimet e karakterit punues do të planifikohen kur shumica e anëtarëve të komisionit janë në dispozicion për të marrë pjesë, ndërkaq për çështjen e organizimit (*vendin, kohën dhe datën*) të takimeve punuese vendos kryetari i KGJ-së. Në rast se ndonjëri nga anëtarët e komisioni mungon pa arsye dhe/ose mungesat e tij/saj janë të njëpasnjëshme qoftë për nga natyra objektive apo subjektive, atëherë kryetari ka një votë më shumë sa i përket organizimit të takimeve punuese.

#### **Neni 15**

Kryetari i komisionit do të funksionalizohet me kompetenca të plota vetëm pas aprovimit të Bordit Ekzekutiv të FKK-së, ndërsa 2 (dy) anëtarët tjerë të komisionit do të funksionalizohen

me kompetenca të plota vetëm pasi që kryetari i komisionit i propozon si anëtarët të rregullt të komisionit dhe merr aprovimin e Bordit Ekzekutiv të FKK-së.

#### **Neni 16**

1. Secili anëtar i komisionit duhet të posedojë kualifikime (*licenca valide*) Europiane ose Botërore në diciplinat Kata dhe/ose Kumite, të njohura nga Federata Europiane e Karatesë (*EKF*) dhe/ose Federata Botërore e Karatesë (*WKF*), përveç rasteve kur kryetari i komisionit propozon ose mbështetë propozimin eventual për pranimin e një anëtari të komisionit me licencë Shtetërore.
2. Komisioni i gjyqtarëve duhet të ketë minimum 2 anëtar me licenca valide Europiane dhe/ose Botërore, ndërsa me licencë shtetërore lejohet vetëm një anëtar nëse caktohet sipas pikës 1 të këtij Neni.
3. Pjesë e komisionit të gjyqtarëve detyrimisht duhet të jenë gjyqtarët të cilët plotësojnë kushtet e parapara sipas pikës 1 të këtij Neni si dhe kushtet e parapara si në vazhdim:

*3.1 Gjyqtarët me përvojë minimale 5 vjeçare në garat shtetërore;*

*3.2 Gjyqtarët me përvojë 3 vjeçare në garat ndërkombëtare;*

*3.3 Gjyqtarët jo më të rinjë se mosha 26 vjeçare;*

*3.4 Gjyqtarët të cilët nuk janë suspenduar 5 vitet e fundit nga ndonjë komision legjitim;*

*3.5 Gjyqtarët të cilët nuk janë nënshtruar ndonjë mase dicipline pranë FKK-s në 3 vitet e fundit;*

*3.6 Gjyqtarët me licenca shtetërore të cilët kanë treguar performancë (janë notuar) mbi mesatare në 3 vitet e fundit në gara shtetërore.*

#### **Neni 17**

Të gjithë anëtarët e komisionit të gjyqtarëve kanë të drejtë vote në mënyre të barabartë (*një anëtar, një votë*), përveç rasteve kur një anëtar mungon dhe mungesa e tij/saj nuk ka arsye bindëse, të fortë, të qëndrueshme dhe rezulton se mungesa e tij/saj është qëllimkeqe atëhere kryetari i komisionit ka të drejtën e votës një plus një (1+1 votë) nëse ka pajtushmëri të plotë nga anëtari tjetër i komisionit.

#### **Neni 18**

Asnjë anëtar i komisionit të gjyqtarëve apo/dhe gjyqtarë nuk mund të emërohet apo të është emëruar në ndonjë pozitë të lartë udhëheqëse në FKK dhe as ushtrues detyre i ndonjë pozite të lartë rrespektivisht vendimmarrëse, ekzekutive dhe menaxheriale në FKK, përveç rasteve kur me statut të FKK-s parashihet ndryshe.

#### **Neni 19**

Anëtarët e komisionit të gjyqtarëve nuk mund të jenë paralelisht kryesues apo anëtar i ndonjë komisioni tjetër pranë FKK-së, ndërsa gjyqtarët mund të jenë anëtar në ato komisione në të cilat nuk përbëhet konflikt interesi i tërthort dhe/ose i drejtpërdrejt me pozitën e gjyqtarit.

#### **Neni 20**

Përfshirë nga neni 19 i kësaj rregulloreje bën kryetari i komisionit me ç`rast për të mirën dhe zhvillimin e sportit të Karatesë dhe në interes të gjithmbarshëm të FKK-s, Bordi Ekzekutiv i FKK-s mund të e angazhoj kryetarin e komisionit me detyrë të përkohshme në punë të tjera.

#### **Neni 21**

KGJ ka për detyrë që në të gjitha rastet eventuale kur kjo rregullore bie ndesh me rregullorën e garave të Federatës Botërore të Karatesë (WKF) të e respektojë këtë të fundit dhe jo rregulloren e komisionit të gjyqtarëve.

#### **Neni 22**

KGJ, është kompetent për të revokuar vendimet të cilat i ka nxjerrë vetë me përjashtim të rasteve kur me statut të FKK-së parashihet ndryshet.

#### **Neni 23**

Bordi Ekzekuti i FKK-së është organ i cili monitoron dhe vlerëson punën e KGJ dhe në të njëjtën kohë jep rekomandimet në interes të Federatës dhe sportit në përgjithësi, përveçse nëse me statut është paraparë ndryshe.

#### **Neni 24**

Bordit Ekzekutiv të FKK-së i përket kompetenca për të rishqyrtuar, pezulluar apo shfuqizuar vendimet e KGJ si organ më i lartë në raport me KGJ dhe atë mbi bazën e kërkesës së palëve të interesuara. Për vendimet të tilla Bordi duhet të njoftoj me shkrim KGJ dhe palët e interesuara.

## **KREU II KOMPETENCAT DHE PËRGJEGJËSITË**

#### **Neni 25**

#### **Komisioni i gjyqtarëve**

1. Komisioni i gjyqtarëve do të jetë përgjegjës dhe kompetent për menaxhimin, mbikqyrjen, kontrollën, ndërmarrjen e masave dicitplnore, avancimet, shpërblimet si dhe licencimin në nivel shtetëror të gjyqtarëve të regjistruar në Federatën e Karatesë së Kosovës.
2. Komisioni i gjyqtarëve do të jetë përgjegjës dhe kompetent për delegimin e gjyqtarëve në garat zyrtare të FKK-së (*kampionate dhe turne*) dhe në garat ndërkombëtare të parapara për pjesëmarrje sipas kalendarit të FKK-së dhe të tjera.
3. KGJ do të monitoroj dhe vlerësoj punën e gjyqtarëve gjatë kampionateve dhe turneve shtetëror dhe ndërkombëtar të planifikuar në kalendarin e garave nga Federata e Karatesë e Kosovës dhe të tjera.
4. KGJ do të përzgjedhë gjyqtarët dhe do të caktoj numrin e tyre për pjesëmarrje në garat shtetërore, rajonale dhe ndërkombëtare përfshirë edhe provimet për gjyqtarë në nivel rajonal dhe ndërkombëtarë sipas parimit të vendosjes me shumicë, respektivisht Nenit 17 të Kreut I të kësaj rregulloreje.
5. KGJ apo njëri nga anëtarët (*i autorizuar nga Kryetari i Komisionit*) duhet të organizohet dhe të bashkëpunoj me sekretarin e përgjithshëm të FKK-së për furnizim me certifikata, ëmblema dhe të gjithë logjistikën e gjyqtarisë të cilat duhen për zhvillimin e seminareve, provimeve dhe gjëra të tjera që kërkohen nga ana e komisionit për plotësimin e programit të tij në përgjithësi.
6. Komisioni i gjyqtarëve është përgjegjës për përgatitjen, dizajnimin, përshkrimin dhe përmbajtjen e diplomave dhe ëmblemave të gjyqëtarëv vendor, si dhe të gjitha materialet tjera logjistike (*format e notimit për gjyqtarët, format e raporteve, databazën digjitale si*

*dhe kopje fizike, format e vlerësimeve vjetore për secilin gjyqtarë etj*) që i duhen komisionit për kryerjen e punëve dhe realizimin e planit të tij.

7. Komisioni i gjyqtarëve ose një i emëruar (*autorizuar nga kryetari i komisionit*) do të inspektoj vendin e propozuar për zhvillimin e seminareve dhe provimeve për gjyqtarë.
8. Komisioni i gjyqtarëve duhet të publikoj rregullorën e garave të përkthyer nga një zyrë profesionale e përkthimeve në origjinal në Gjuhën Shqipe dhe atë në faqën zyrtare të FKK-së dhe disa ekzemplarë kopje fizike duhet të jenë në zyret e FKK-së.
9. Komisioni i gjyqtarëve detyrimisht duhet të bëjë vlerësimin e gjyqtarëve shtetëror pas çdo aktiviteti zyrtar të FKK-së si dhe të njejtat duhet t'i arkivoj në bazën e shënimeve që posdeon komisioni i gjyqtarëve pranë FKK-së.
10. Komisioni i gjyqtarëve detyrimisht duhet të bëjë vlerësimet vjetore për gjyqtarët me licenca shtetërore, rajonale dhe ndërkombëtare (*për secilin veç e veç*) pas mbylljes së vitit kalendarik dhe të njejtat duhet të i arkivoj në bazën e shënimeve të komisionit të gjyqtarëve pranë FKK-së gjithasthu t'i shpërndajë secilit gjyqtarë individualisht në kopje fizike dhe/apo digjitale.
11. Komisioni i gjyqtarëve është i vetmi organ kompetent për zgjidhjen e të gjitha çështjeve që ndërlidhen me gjyqtarët dhe gjyqtarinë në përgjithësi e të cilat nuk janë paraparë me këtë rregullore apo rregulloren e garave të Federtaës Botërore të Karatesë (WKF).
12. Në rast të kërkesës për shiptim të ndonjë mase disiplinore, KGJ duhet të informoj me shkrim Bordin Ekzekutiv të FKK-së dhe Komisionin Disiplinor si dhe personin apo personat ndaj të cilëve kërkohet masa disiplinore.

## **Neni 26**

### **Kryetari i komisioni të gjyqtarëve**

1. Kryetari i Komisionit (*tutje si Kryesuesi*) është përgjegjës dhe kompetent për të ruajtur standardet e gjyqtarisë, interpretimin korrekt të rregullave dhe mbikqyrjen e zbatimit të tyre nga ana e gjyqtarëve përfshirë edhe anëtarët e KGJ-së.
2. Kryesuesi do të informojë dhe komunikoj zyrtarisht për të gjitha organizimet e seminareve dhe provimeve për gjyqtarë në nivel shtetëror dhe ndërkombëtar, duke përfshirë kohën, datën, vendin dhe të tjera.
3. Kryesuesi, mund të autorizojë njërin nga anëtarët e komisionit për kryerjen e të gjitha punëve të komisionit brenda kompetencave të tij si dhe zëvendësimin, përfaqësimin e kryetarit të komisionit në të gjitha garat, seminarët dhe provime etj. Autorizimi duhet të bëhet në formë të shkruar, me vulën e komisionit respektivisht kryetarit të komisionit si dhe nënshkrimin e autorizuesit.
4. Kryesuesi duhet të bëjë kontrollimin, vlerësimin dhe monitorimin e anëtarëve të komisionit dhe të gjithë gjyqtarëve të licencuar pranë FKK-së.
5. Kryesuesi i gjyqtarëve është organi i vetëm kompetent i cili mund të lirojë nga detyra anëtarin ose anëtarët e komisionit të gjyqtarëve si i vetmi organ i cili emëron ata duke u

bazuar në statutin e FKK-s, nenin 12, pika 12.2 dhe sipas nenit 11, pika 1.2 të kësaj rregulloreje.

6. Kryesuesi, ka të drejtën ekskluzive të bëjë delegimin e punëve tek anëtarët e komisionit sipas kompetencave dhe brenda rregullores së punës, refuzimi për të bërë këtë nga cilido anëtar i komisionit pa arsye të qëndrueshme dhe reale rezultojn me ndërmarrjen e masave disiplinore ndaj tij/saj sipas nenit 79 dhe/ose largimin e tij nga komisioni sipas pikës 5 të këtij neni, të kësaj rregulloreje.
7. Kryesuesi, ka kompetencat e gjyqtarit suprem në të gjitha garat zyrtare të FKK-së (*Kampionatet shtetërore dhe turnetë zyrtare*) përveç rasteve kur i njejti autorizon – përzgjedh ndonjë gjyqtarë tjetër.
8. Kryetari i komisionit gjegjësisht gjyqtari suprem do të caktoj kontrollorët për çdo garë zyrtare të FKK-s si dhe/apo garat që janë në nivel mbarëkombëtarë në koordinim me komisionet tjera relevante.
9. Kryesuesi është kompetent të komunikoj nëpërmjet FKK-së me komisionet apo homologët tjerë në nivele rajonale, europiane dhe botërore në lidhje me zhvillimin e politikave të gjyqtarisë, pjesëmarrjen e gjyqtarëve në gara dhe seminare, kërkesave për delegimin e gjyqtarëve në gara dhe çështje tjera që ndërlidhen me gjyqtarinë, në rastin e kundërt, ndaj secilit person i cili vepron në kundërshtim me këtë nen respektivisht këtë pikë të kësaj rregulloreje do të inicohet procedurë disiplinore ndaj tij/saj.
10. Kryesuesi për punët e tij dhe komisionit të gjyqtarëve i përgjigjet dhe raporton drejtpërdrejtë bordit të FKK-së mbi baza vjetore por edhe sipas kërkesës dhe në raste të caktuara kur bordi kërkon një gjë të tillë. Raportimi duhet të bëhet në formë të shkruar dhe sipas nevojës edhe me prezencë fizike.

## **Neni 27**

### **Anëtarët e komisioni të gjyqtarëve**

1. Anëtarët e komisionit të gjyqtarëve (tutje si AKGJ) janë përgjegjës për kryerjen e punëve të komisionit të gjyqtarëve të deleguara nga kryesuesi.
2. AKGJ bëjnë monitorimin, kontrollimin dhe asistimin e gjyqtarëve për çështjet që ndërlidhen me rregullat e garave dhe çështje tjera të gjyqtarisë në përgjithësi dhe për të njëjtat informojnë me shkrim apo gojarisht kryesuesin.
3. AKGJ janë të pavarur në vendimmarrje respektivisht në votën e tyre brenda KGJ-së.
4. AKGJ detyrimisht duhet të informojnë kryesuesin për çdo parregullsi eventuale që identifikohet nga ana e tyre e që ndërlidhet me gjyqtarët e FKK-së dhe gjyqtarinë në përgjithësi.
5. AKGJ janë të obliguar të marrin pjesë në të gjitha mbledhjet e KGJ të cilat i organizon (*cakton*) kryesuesi, për çdo mungesë ose pamundësi të marrin pjesë në mbledhjet e thirrura nga kryesuesi AKGJ mënjherë duhet të informojnë kryesuesin e komisionit të gjyqtarëve.
6. AKGJ pas çdo gare zyrtare të FKK-së duhet të përpilojnë raporte me shkrim në lidhje me punën e gjyqtarëve dhe atë për secilin veç e veç duke përfshirë rekomandimet, vlerësimet me nota, vërejtjet, lëvdatat dhe të njëjtat i dorëzojnë kryesuesit.



7. AKGJ ndihmojnë kryesuesin për kryerjen e punëve të komisionit, asistojnë në organizimet e ndryshme brenda Kosovës dhe jasht saj.
8. AKGJ mund të inicoj procedurë disiplinore ndaj një ose më shumë gjyqtarëve, në rast se janë plotësuar kushte për incimin e një procedure të tillë dhe të njejtën, në formë të shkruar duhet të dorëzojnë tek kryesuesi.
9. AKGj mund të japin rekomandimet e tyre në lidhje me delegimin e gjyqtarëve në garat shtetërore dhe ndërkombëtare duke i dorëzuar në formë të shkruar tek kryesuesi.
10. AKGJ janë të obliguar të ruajn në çdo kohë, çdo vend dhe çdo rast tjetër interesat e FKK-së në përgjithësi si dhe gjyqtarisë në veçanti, në rastin e kundërt ndaj secilit anëtar mund të inicohen masa disiplinore.
11. AKGJ janë të obliguar të qëndrojnë diskret, të shmangin dhe evitojnë çdo konflikt interesi qoft në garë apo jasht saj, dhe për çdo rast të tillë menjëherë duhet të informojnë kryesuesin duke dhënë sqarime dhe rekomandimet e tij/saj për hapat dhe zhvillimet e më tutjeshme.
12. AKGJ për punën e tyre përgjigjen dhe raportojn tek kryesuesi mbi baza vjetore por edhe sipas kërkesës dhe në raste të caktuara kur kryesuesi kërkon një gjë të tillë.
13. Anëtarët e komisionit mund të delegohen si kontrollor në garat zyrtare të FKK-së, përjashtim bëjnë rastet kur kryesuesi vendos për angazhimin e një gjyqtari (*i certifikuar*) në detyrë të kontrollorit me kompetencat e parapara sipas rregullores së komisionit si dhe rregullores së garave.

## **Neni 28**

### **Sekretari teknik i komisionit të gjyqtarëve**

1. Sekretari i komisioni të gjyqtarëve (tutje si SK) emërohet sipas nevojës dhe atë nga kryesuesi në bashkvotim me anëtarët e komisionit. SK, duhet të jetë anëtar i FKK-së dhe minimalisht me licencë profesionale shtetërore.
2. SK, posedon mandat 1 vjeçar me mundësi ri-emërimi nga KGJ dhe të njejtin mund të e liroj nga detyra në çdo kohë.
3. SK, nuk ka të drejtë vote dhe nuk posedon përgjegjësi vendimmarrëse në komisionin e gjyqtarëve.
4. SK, merrë pjesë në mbledhjet e komisionit, përpilon procesverbalet, përgatitë materialet e duhura për kryerjen e punëve të komisionit, informon kryesuesin apo cilindo anëtarë të komisionit për ndonjë parregullësi eventuale.
5. SK kryen punë tekniko-administrative të KGJ të cilat i delegohen nga kryesuesi dhe/ose AKGJ.
6. SK, për punën e tij i raporton KGJ.

### KREU III LICENCIMI DHE TITUJT E GJYQTARËVE

#### Neni 29

1. KGJ është i vetmi organ kompetent për licencimin e gjyqtarëve të FKK-së me licenca shtetërore.
2. KGJ duhet të pajis të gjithë gjyqtarët e licencuar me diploma, ëmblema dhe librezat e gjyqtarisë për titujt përkatës, diploma e lëshuar është valide vetëm pas vulosjes nga FKK dhe nënshkrimit nga ana e kryetarit të komisionit ose anëtarit të autorizuar.
3. Komisioni i gjyqtarëve pranë FKK-së, zyrtarisht njeh dhe pranon 5 lloje të licencave;
  - 3.1 Licencat Shtetërore të lëshuara nga KGJ pranë FKK-së; (FKK-KKF)
  - 3.2 Licencat Shtetërore të lëshuara nga Federatat përkatëse anëtare të EKF dhe WKF;
  - 3.3 Licencat Ballkanike të lëshuara nga Federata Ballkanike e Karatesë; (BKF)
  - 3.4 Licencat Europiane të lëshuara nga Federata Europiane e Karatesë; (EKF)
  - 3.5 Licencat Botërore të lëshuara nga Federata Botërore e Karatesë; (WKF)
4. Të gjitha llojet tjera të licencave që nuk janë sipas pikës 3 të këtij neni do të konsiderohen jo zyrtare dhe rrijedhimisht nuk do të pranohen nga KGJ.

#### Neni 30

#### Kushtet për licencim

1. Secili individ pavarësisht gjinisë, racës, etnisë, i cili është më i ri se 21 vjeçar nuk mund të aplikojë për gjyqtarë të FKK-së.
2. Çdo individ i cili dëshiron të aplikoj për gjyqtar pranë FKK-së duhet të ketë minimum gradën mjeshtërore 1 DAN për diciplinën KUMITE dhe 2 DAN për diciplinën KATA të certifikuar nga komisioni i gradave respektivisht nga FKK-ja.
3. Secili kandidat i cili aplikon për licencë fillestare apo për avancim duhet të paguaj taksën seminarike dhe të provimit e caktuar sipas të caktuar me vendim të Bordit Ekzekutiv.
4. Çdo kandidat i cili aplikon për herë të parë (*licencë fillestare*) apo për t'u avancuar duhet të dorëzoj në zyrat e FKK-së dokumentacionin si në vijim:
  - 4.1 Dëshmi mbi pagesën e taksës seminarike dhe të provimit;
  - 4.2 Kopjen e letërnjoftimit;
  - 4.3 Aplikacionin për gjyqtar;
  - 4.4 Gjyqtarët të cilët aplikojnë për avancim duhet të sjellin edhe librezën e gjyqtarisë.
5. Dështimi, apo mos kompletimi i dokumentacionit sipas pikës 4 të këtij neni do të ketë për pasojë përjashtimin e kandidatit/ëve nga lista e provimi.
6. Çdo licencë e lëshuar nga KGJ e ka afatin e skandencës 4 vite nga data kur është lëshuar.

7. Çdo gjyqtarë i regjistruar në FKK-së duhet t'i nënshtrohet provimit për rilicencim pas çdo afati të skadencës ose edhe para afatit të skadencës, *(në këtë rast afati i ri i licencës shënohet nga data e provimit të fundit)*.
8. Për të gjithë gjyqtarët të cilët posedojnë licencë/a Ballkanike dhe/ose Europiane (*EKF*) dhe/ose Botërore (*WKF*) nuk vlenë pika 6 dhe 7 e këtij neni, ngase të njëjtit janë të licencuar nga komisionet përkatëse Ballkanike dhe/ose Europiane dhe/ose Botërore si organe më të larta se KGJ pranë FKK-së, në këtë rast afati i skadencës për licencat shtetërore vazhdojnë me automatizëm.
9. Nëse një gjyqtari i skadon licenca shtetërore dhe kalojnë më shumë se 4 vite me afat të skaduar, ai gjyqtarë nuk mund të rilicencohet për titullin e njëjtë që ka poseduar para 4 viteve, i njëjti do të aplikojë për një shkallë më të ulët, nëse licenca shtetërore kalon më shumë se 6 vite me afat të skaduar atëherë i njëjti duhet të rifillojë nga e para.
10. Çdo kandidat i interesuar mund të aplikoj ndaras vetëm për disiplinën KUMITE apo KATA ose për të dyja njëkohësisht.

### Neni 31 Titujt dhe Licencat Shtetërore

1. Licencat e lëshuara duhet të protokolohen nga komisioni i gjyqtarëve, të vulosën me vulën e komisionit dhe të nënshkruhen nga kryesuesi dhe presidenti i FKK-së.
2. Titujt shtetërore ndahen në dy disiplina dhe dy nivele:
  - 2.1 Titujt e nivelit **FILLESTAR** në disiplinat KUMITE dhe KATA
    - 2.1.1 *Kumite - Gjyqtar ndihmës B dhe A (JUDGE B/A)*
    - 2.1.2 *Kata - Gjyqtar ndihmës B (JUDGE B)*
  - 2.2 Titujt e nivelit **PROFESIONAL** në disiplinat KUMITE dhe KATA
    - 2.2.1 *Kumite - Gjyqtar Kryesor B dhe A (REFEREE B/A)*
    - 2.2.2 *Kata - Gjyqtar A (JUDGE A)*
3. Niveli i titujve shtetërore fillon nga titujt fillestar B dhe A, dhe vazhdon me titujt e nivelit profesional B dhe A. Titujt B janë të nivelit më të ulët se ato A.
4. Asnjë gjyqtar nuk mund të kalojë apo avancohet pa ju nënshtruar seminareve dhe provimeve përkatëse të organizuara nga KGJ.
5. Asnjë kandidat apo gjyqtar nuk mund të licencohet apo avancohet për dy tituj njëkohësisht, secili gjyqtar detyrimisht duhet të kalojë provimet sipas rradhës së titujve, dhe atë sipas pikës 3 të këtij neni duke filluar nga titujt fillestar deri tek ata profesional.
6. Asnjë gjyqtar/e nuk mund të delegohet për licenca rajonale apo ndërkombëtare pa i përfunduar me sukses të gjitha nivelet shtetërore.

**Neni 32**  
**Titujt dhe licencat Rajonale dhe Ndërkombëtare**

1. Komisioni i gjyqtarëve duhet të njoh gjitha licencat valide të cekura në nenin 29, pikën 3, por jo në rast se të njëjtat janë të pezulluara, skaduara apo suspenduara.
2. Licencë ndërkombëtare konsiderohet licenca e lëshuar nga Federata Europiane e Karatesë (EKF) dhe Federata Botërore e Karatesë (WKF).
3. Licencë rajonale konsiderohet licenca e lëshuar nga Federata Ballkanike e Karatesë dhe Fedetara Mesdhetare (*mediterane*) e Karatesë.
4. Komisioni i gjyqtarëve detyrimisht duhet të respektoj dhe njoh kategorizimin dhe nivelin e licencave rajonale dhe ndërkombëtare të Federatave përkatëse të njohura nga KGJ sipas KREU III, neni 29, pika 3 e kësaj rregulloreje.
5. Bordi drejtues i FKK-s, anëtarëve të KGJ të cilët posedojnë licencat ndërkombëtare sipas pikës 2 të këtij neni duhet të ju mbulojë taksën e ripërtitjes së licencës e njohur sipas WKF dhe EKF (PLR) "*Payment Licence Renewal*".
6. Bordi drejtues i FKK-s, gjyqtarëve të deleguar (*përzgjedhur*) nga KGJ për të ndarë drejtësinë dhe/ose nënshtruar provimet për licenca rajonale dhe/ose ndërkombëtare duhet të ju mbulojë të gjitha shpenzimet sipas rregullores për meditje dhe shpërblime duke përfshirë edhe taksën e provimeve.
7. KGJ, nuk ka kompetencë dhe nuk mund të pezulloj apo suspendoj licencat ndërkombëtare dhe rajonale përderisa të njëjtat nuk janë pezulluar apo suspenduar nga organet të cilat i kanë lëshuar ato.
8. KGJ, ka të drejtën të parashtrij kërkesën me shkrim Kryetarit të FKK-së, dhe/apo bordit ekzekutiv të FKK-së për t'i përcjellë kërkesën organeve kompetente ndërkombëtare dhe/apo rajonale për pezullimin apo suspendimin e licencës/ave Rajonale dhe/apo ndërkombëtare të gjyqtarit apo gjyqtarëve të FKK-së në rastet kur:
  - 8.1 Kërkesa për pezullim dhe/apo suspendim përmbanë arsye të fortë bindëse, provat në lidhje me shkeljet e pretenduara eventuale të cilat paraqesin ose dëshmojnë probleme serioze dhe qëllimqija në nivel ndërkombëtarë apo Shtetëror.
  - 8.2 Kërkesa është e miratuar **unanimisht** (pa asnjë votë kundër) sipas Nenit 17, të kësaj rregulloreje.
  - 8.3 Gjyqtari apo gjyqtarët thyen rregullat ndërkombëtare, shkelin rregulloren e konflikt interesit të WKF, EKF, dhe FKK-së, kur të njëjtit keqpërdorin licencat e tyre ndërkombëtare apo autoritetin e tyre për përfitime personale apo të tjerëve në mënyrë të jashtëligjshme.
  - 8.4 Gjyqtari apo gjyqtarët të cilët pa autorizimet dhe/apo lejen e KGJ marrin pjesë dhe përfaqësojnë në gara, seminare dhe/apo provime, një shtet tjetër, federatë, klub apo çfarëdo organizate apo institucioni i cili nuk i takon Republikës së Kosovës.

8.5 Pezullimi apo/dhe suspendimi i licencave ndërkombëtare do të vlejë për aq kohë sa do ta caktoj organi gjegjësisht komisionet përkatëse të gjyqtarëve nga BKF, EKF dhe WKF.

9. Çdo licencë ndërkombëtare dhe rajonale do të ketë afatin e skadencës sipas rregullave të Federatës përkatëse e cila ka lëshuar ato. Licencat e tilla me afat të skaduar KGJ do të i konsideroj jo valide pavarësisht nivelit apo titullit që posedon gjyqtari apo gjyqtarët.
10. Gjyqtarët të cilët posedojnë tituj dhe licenca ndërkombëtare do të kenë përparsi për t'u deleguar në garat shtetërore në raport me gjyqtarët me licenca shtetërore, kjo përshkak të ngritjes së cilësisë dhe avancimit të sportit të Karatesë.

## **KREU IV SEMINARET DHE PROVIMET PËR GJYQTARË**

### **Neni 33 Seminaret**

1. Seminaret e organizuara nga FKK respektivisht KGJ kanë për qëllim ngritjen e cilësisë, informimin e gjyqtarëve për ndryshimet e rregullave, avancimin e gjyqtarëve, seleksionimin e gjyqtarëve të rinjë, ngritjen e kapaciteteve profesionale të gjyqtarëve dhe trajnerëve.
2. Të gjithë gjyqtarët e FKK-s apo/dhe kandidatët e rinjë, detyrimisht duhet të marrin pjesë të paktën njëhere në vit në seminaret e organizuara nga KGJ pranë FKK-s dhe në rastet kur rregullorja e garave pëson ndryshime.
3. KGJ, është i vetmi organ pranë FKK-së i cili është kompetent për organizimin e seminareve zyrtare në nivel shtetëror për gjyqtarët në lidhje me rregullat e garave të federatës botërore të Karatesë (WKF).
4. Çdo individ – person i cili dëshiron të posedoj licencë të gjyqtarisë pranë FKK-së ka të drejtë dhe detyrimisht duhet të marr pjesë në seminaret e organizuara për gjyqtarë.
5. Çdo individ – person i cili plotëson kushtet e parapara në nenin 30 të kësaj rregulloreje, ka të drejtë të marr pjesë në seminaret e organizuara nga KGJ.
6. KGJ, çdo vit në 3 mujorin e parë të vitit dhe/ose pjesën e dytë të vitit mund të organizoj seminaret për rregullat e garave në Karate.

*6.1 Orari, koha dhe vendi i zhvillimit të seminarit do të caktohet nga komisioni i gjyqtarëve. Njoftimi zyrtarë duhet të bëhet 30 ditë kalendarike para datës zyrtare të zhvillimit të Seminarit, në rastet kur seminari ka karakter ndërkombëtar dhe zhvillohet në Kosovë, atëhere publikimi i datës, vendit dhe orës duhet të bëhet 60 ditë kalendarike para datës zyrtare të zhvillimit të seminarit.*

7. Komisioni i gjyqtarëve është i vetmi organ kompetent për organizimin, planifikimin dhe ligjerimin e seminareve, përjashtim bëjnë rastet kur seminaret zhvillohen nga komisionet respektivisht anëtarët e komisioneve apo gjyqtarët ndërkombëtare (të jashtëm), në këtë rast KGJ do të bëjë organizimin dhe monitorimin teknik të seminarit.

8. Seminaret ndahen në dy pjesë, në seminarin teorik dhe praktik, dështimi për të vijuar të dy pjesët e seminarit nga cilido kandidat apo gjyqtarë, do të konsiderohet i pa kompletuar.
9. Të gjitha seminarët e organizuara zyrtarisht nga një federatë anëtare e EKF dhe WKF me karakter shtetëror, rajonal dhe ndërkombëtarë do të pranohen nga KGJ dhe njëkohësisht do të regjistrohen në bazën e shënimeve për secilin gjyqtarë.

*9.1 Pjesëmarrja në këto seminare duhet të dokumentohet me dokumentat dhe/ose vërtetimet relevante nga Federatat respektivisht komisionet përkatëse.*

10. Të gjithë pjesëmarrësit në seminar duhet të paguajn paraprakisht taksën seminarike sipas vendimit të Bordit Ekzekutiv. KGJ, me një vendim të aprovuar nga Bordit Ekzekutiv i FKK-së seminarët mund t'i organizoj edhe pa pagesë për të gjithë pjesëmarrësit.
11. Bordi Ekzekutiv i FKK-s, do të mbuloj të gjitha shpenzimet dhe do të siguroj të gjitha kushtet për zhvillimin e seminareve në bashkupim me KGJ dhe të tjera.

### **Neni 34 Provimet**

1. Provimet e organizuara nga FKK-ja respektivisht KGJ-ja kanë për qëllim ngritjen e cilësisë së gjyqtarëve, avancimin dhe seleksionimin e gjyqtarëve të rinjë, ngritjen profesionale të gjyqtarëve si dhe përgatitjen e tyre për nivele rajonale dhe ndërkombëtare.
2. Çdo individ – person i cili dëshiron të posedoj licencë të gjyqtarisë pranë FKK-së detyrimisht duhet të i nënshtrohet provimit për gjyqtarë të organizuar nga KGJ.
3. Çdo individ – person i cili plotëson kushtet e parapara në nenin 30 të kësaj rregulloreje, ka të drejtë të i nënshtrohet provimit të organizuar nga KGJ.
4. KGJ, mund të organizoj vetëm njëherë në vit provimin për gjyqtarë, përjashtim bëjnë rastet kur komisioni i gjyqtarëve vlerëson se kërkesa dhe numri i kandidatëve është i madh (*10 e më shumë aplikantë*) atëherë KGJ mund të organizojë edhe një provim por jo më shumë për atë vit kalendarik.
5. KGJ, çdo vit në 3 mujin e parë të vitit dhe/ose pjesën e dytë të vitit mund të organizoj provimin për gjyqtar.

*5.1 Orari, koha dhe vendi i zhvillimit të provimit do të caktohet nga komisioni i gjyqtarëve. Njoftimi zyrtar duhet të bëhet 30 ditë kalendarike para zhvillimit të provimit, në rastet kur provimi ka karakter ndërkombëtar dhe zhvillohet nga FKK-ja atëherë publikimi i datës, vendit dhe orës duhet të bëhet 75 ditë kalendarike para datës së zhvillimit të provimit.*

6. Çdo kandidat - gjyqtar duhet të i nënshtrohet provimit pranë KGJ në të gjitha rastet kur:

*6.1 Nuk posedon asnjërën nga licencat e parapara në Nenin 29, pikën 3.*

*6.2 Avancimin e mëtutjeshëm – ngirtjen e titujve shtetëror të gjyqtarisë;*

*6.3 Skadon afati i licencës shtetërore;*

*6.4 Licenca e paraparë në Nenin 29, pikën 3.1 të kësaj rregulloreje që ka kaluar më shumë se 4 dhe 6 vite me afat të skadencës.*

7. Provimet ndahen në dy pjesë, provimi teorik dhe praktik, dështimi për të vijuar të dy pjesët e provimit nga cilido kandidat, do të konsiderohet i pa kompletuar dhe si i tillë kandidati do të humbë të drejtën për licencim, rilicencim dhe/apo avancim.

*7.1 Provimi Teorik do të zhvillohet në të njëjtën kohë për të gjithë kandidatët të cilët aplikojnë.*

8. KGJ do të vendosë për metodologjinë e zhvillimit të provimit, numrin e pyetjeve në Kumite dhe Kata dhe sistemin e vlerësimit në pjesën praktike, *(preferohet metodologjia e njëjtë me Federatën Europiane dhe Botërore të Karatesë).*
9. Provimi Praktik do të zhvillohet pas përfundimit të provimit teorik nga ana e kandidatëve dhe atë në garën e parë zyrtare sipas kalendarit të garave të FKK-s.

*9.1 Provimi praktik mund të zhvillohet edhe ndaras në një vend dhe kohë tjetër të caktuar nga KGJ, në këtë rast ky provim duhet të organizohet para garës së parë zyrtare sipas kalendarit të garave të FKK-së.*

*9.2 KGJ, në bashkpunim me komisionet përkatëse dhe bordin drejtues të FKK-s për provimet e organizuara sipas pikës 9.1 të këtij neni do të siguroj garuesit, doktorin dhe të gjithë infrastrukturën e duhur për zhvillimin e provimit.*

*9.3 Provimet e oragnizuara si në pikën 9.1 të këtij neni, janë specifike për shkak të implikimeve buxhetore dhe angazhimeve të tjera, andaj ato oragnizohen kur mundësia e zhvillimit të provimit në një garë është minimale, dhe për çfarëdo arsye tjetër pamundësohet zhvillimi i provimit në një garë.*

### **Neni 35**

#### **Kushtet teknike minimale për zhvillimin e seminareve dhe provimeve**

1. Për zhvillimin e seminarit dhe provimit teorik, KGJ i duhet një sallë në të cilën mund të akomodohen së paku 50 persona. Salla duhet të jetë e pajisur me një projektor dhe/ose LCD ekran të përshtatshëm dhe me dukshmëri të mirë nga të gjitha anët e sallës, si dhe pasijen digjitale kompjuterike (PC ose Laptop). Salla duhet të ketë karriget për së paku 55 persona, tavolinat ku mund të ulen 1 deri në 3 persona por jo më shumë.
2. Për zhvillimin e seminarit praktik në diciplinën Kumite dhe/ose Kata, KGJ i duhet një sallë në të cilën mund të vendoset së paku një arenë (*tatami*) me dimensione 10x10m (*arena e përcaktuar sipas dispozitave të WKF*) dhe të jetë e pajisur me karriga të mjaftueshme, sinjalizim, kohëmatës, tatami të miratuar nga FKK (WKF), të ketë jo më pak se 10 garues kualitativ për mbarëvajtjen e seminarit, si dhe mjekun zyrtar të FKK-s.
3. Për zhvillimin e provimit praktik sipas nenit 34, pikave 9, 9.1, KGJ i duhen të gjitha kushtet e parapara sipas pikës 2 të këtij neni si dhe pikës 9.2 nga neni 34.

### **Neni 36**

KGJ në bashkëpunim me bordin drejtues të FKK-s dhe komisionet tjera relevante, do të siguroj të gjitha kushtet e parapara sipas nenit 34, pikës 9 dhe nenit 35 të kësaj rregulloreje

për zhvillimin e seminareve dhe provimeve, ndërkaq për çështjet teknike rreth organizimit të seminareve dhe provimeve nga komisioni i gjyqtarëve duhet të përkujdesën sekretari i komisionit të gjyqtarëve dhe zyrtja e administratës pranë FKK-s.

### Neni 37

Bordi Ekzekutiv i FKK-s do të mbulojë të gjitha shpenzimet dhe të ofrojë të gjitha kushtet e parapara me këtë rregullore për zhvillimin e seminareve dhe provimeve për gjyqtarë.

### Neni 38

#### Kriteret për dhënjen e Provimit

1. Çdo gjyqtarë apo kandidat fillestar duhet të plotësojë kriteret dhe kushtet e parapara me këtë rregullore për të kaluar provimin me sukses.
2. KGJ ka të drejtë dhe është i vetmi organ kompetent për të caktuar dhe ndryshuar kriteret e kalueshmërisë së provimit për gjyqtarë të nivelit profesional dhe fillestar nëpërmjet kësaj rregullore dhe pas aprovimit të Bordit drejtues të FKK-s.
3. Kriteret e kalueshmërisë së provimit përcaktohen dhe ndahen për pjesën teorike të provimit dhe për pjesën praktike të provimit.
  - 3.1 Pjesa teroike e provimit përbëhet prej 70 pyetjeve për diciplinën Kumite dhe 50 pyetjeve për diciplinën Kata. Provimi teorik zhvillohet me shkrim me ç'rast kandidatët do të përgjigjen duke u përcaktuar për e SAKT ose e PA SAKT. Numri i pyetjeve mund të ndryshoj, sipas ndryshimeve/plotësimeve të rregulloreve të WKF/EKF.
  - 3.2 *Pjesa praktike e provimit për diciplinën KUMITE vlerësohet me nota në mënyrë individuale duke u bazuar në përformimin e kandidatëve dhe/ose gjyqtarëve, ndërkaq për diciplinën e KATA-ve kandidatët duhet të vlerësojnë (gjykojnë) 10 meqe individuale dhe/ose ekipore, të përgatitura dhe lëshuara me video-inxhizime.*
  - 3.3 *Gjyqtari i cili aplikon për t'u rilicencuar apo avancuar në titullin profesional "Gjyqtarë Kryesor A" KUMITE (Referee A) sipas nenit 31, pikat 2 dhe 3, të kësaj rregulloreje nuk duhet të ketë dhënë më shumë se 8 përgjigje të gabuara, 9 e më shumë përgjigje të gabuara konsiderohet rezultat negativ, ndërkaq për pjesën praktike duhet të ketë marrë vlerësimin minimal me notën 4, 3.99 e më pak konsiderohet rezultat negativ.*
  - 3.4 *Gjyqtari i cili aplikon për t'u rilicencuar apo avancuar në titullin profesional "Gjyqtarë Kryesor B" KUMITE (Referee B) sipas nenit 31, pikat 2 dhe 3, të kësaj rregulloreje nuk duhet të ketë dhënë më shumë se 13 përgjigje të gabuara, 14 e më shumë përgjigje të gabuara konsiderohet rezultat negativ, ndërkaq për pjesën praktike duhet të ketë marrë vlerësimin minimal me notën 3.5, 3.49 e më pak konsiderohet rezultat negativ.*
  - 3.5 *Gjyqtari i cili aplikon për t'u rilicencuar apo avancuar në titullin profesional "Gjyqtarë ndihmës A" KUMITE (Judge A) sipas nenit 31, pikat 2 dhe 3, të kësaj rregulloreje nuk duhet të ketë dhënë më shumë se 17 përgjigje të gabuara, 18 e më shumë përgjigje të gabuara konsiderohet rezultat negativ, ndërkaq për pjesën*



*praktike duhet të ketë marrë vlerësimin minimal me notën 2.5, 2.49 e më pak konsiderohet rezultat negativ.*

3.6 Gjyqtari i cili aplikon për t'u rilicencuar apo avancuar në titullin profesional "Gjyqtarë ndihmës B" **KUMITE (Judge B)** sipas nenit 31, pikat 2 dhe 3, të kësaj rregulloreje nuk duhet të ketë dhënë më shumë se **20 përgjigje të gabuara**, 21 e më shumë përgjigje të gabuara konsiderohet rezultat negativ, ndërkaq për pjesën praktike duhet të ketë marrë vlerësimin minimal me **notën 2.0, 1.99 e më pak konsiderohet rezultat negativ.**

3.7 Gjyqtari i cili aplikon për t'u rilicencuar apo avancuar në titullin profesional "Gjyqtarë A" **KATA (Judge A)** sipas nenit 31, pikat 2 dhe 3, të kësaj rregulloreje nuk duhet të ketë dhënë më shumë se **7 përgjigje të gabuara**, 8 e më shumë përgjigje të gabuara konsiderohet rezultat negativ, ndërkaq për pjesën praktike duhet të ketë dhënë vlerësim të sakt për 8 meqe, 7 meqe e më pak konsiderohet rezultat negativ.

3.8 Gjyqtari i cili aplikon për t'u rilicencuar apo avancuar në titullin profesional "Gjyqtarë A" **KATA (Judge B)** sipas nenit 31, pikat 2 dhe 3, të kësaj rregulloreje nuk duhet të ketë dhënë më shumë se **12 përgjigje të gabuara**, 13 e më shumë përgjigje të gabuara konsiderohet rezultat negati, ndërkaq për pjesën praktike duhet të ketë dhënë vlerësim të sakt për 7 meqe, 6 meqe e më pak konsiderohet rezultat negativ.

4. Vlerësimi i gjyqtarëve do të bëhet me notat duke filluar nga 1 deri 5, me mundësi të dy decimaleve pas presjes dhjetore (p.sh. 1.13; 2.58; 4.43). Ky system i notimit do të vlejë për të gjitha garat dhe provimet praktike të zhvilluara nga KGJ. Nota 1 është më e ulëta (negative) ndërsa nota 5 është më e larta.

5. Detyrat e anëtarëve të komisionit të gjyqtarëve, përfshirë edhe kryesuesin në lidhje me provimin e gjyqtarëve janë: kontrollimi, vlerësimi, korrigjimi dhe shapllja zyrtare e rezultateve përfundimtare të provimit për të gjithë kandidatët.

6. Provimi konsiderohet i përfunduar me sukses për të dy diciplinat (*Kumite dhe Kata*) atëherë kur një kandidat ka arritur rezultat pozitiv në të dy pjesët provimit (*teorik dhe atë praktik*) sipas kritereve të parapara në pikat 3.3, 3.4, 3.5, 3.6, 3.7 dhe 3.8 të këtij neni.

6.1 Kandidati i cili ka rezultat pozitiv në pjesën teorike të provimit *Kata dhe/ose Kumite*, mirëpo ka notë negative në pjesën praktike konsiderohet që nuk ka kaluar provimin me sukses.

6.2 Kandidati i cili ka rezultat pozitiv në pjesën praktike të provimit *Kata dhe/ose Kumite*, mirëpo ka rezultat negativ në pjesën teorike konsiderohet që nuk ka kaluar provimin me sukses.

7. Rezultatet zyrtare duhet të bëhen publike jo më shumë se 7 ditë nga data e përfundimit të provimit. Secili kandidat do të marrë rezultatin individualisht.

8. Secili gjyqtar i cili i nënshtrohet provimit do të pajiset me kodet (numërat) identifikues personal me të cilët pas publikimit të rezultateve kandidatët do të identifikohen sipas kodeve (numërave) të tyre.

9. Në rastet kur një anëtar i komisionit ose kryesuesi për shkaqe të ndryshme objektive apo subjektive mungon apo tërhiqet nga detyrat e tij/saj të përcaktuara sipas pikës 5 të këtij neni në lidhje me provimin e gjyqtarëve, atëhere kryesuesi ka të drejtë të emëroj një gjyqtar tjetër me përvojën dhe licencën më të lartë rajonale apo/dhe ndërkombëtare për të zëvendësuar atë që mungon.
10. Provimi për gjyqtar mund të anulohet për raste specifike për të cilat KGJ me shumicë votash vlerëson se i njëjti duhet të anulohet dhe ripërsëritet. Kandidatët të cilët ripërsërisin provimin për shkak se të njëjtin e ka anuluar KGJ nuk detyrohen të paguajn taksë për provimin e ripërsëritur, në të gjitha rastet tjera duhet të paguajn taksën për provim.

## **KREU VI KODI I SJELLJES**

### **Neni 39 Animi**

Një gjyqtar duhet të jetë i drejtë gjatë gjykimit, i ndershëm dhe i paanshëm gjatë gjithë kohës së një aktiviteti. Ai/ajo nuk duhet të shfaqë favorizime dhe të ketë paragjykime për asnjë individ, garues apo edhe klub. Mos respektimi i këtij neni nga cilido gjyqtarë përfshirë edhe anëtarët e komisionit do të ketë për pasojë ndërmarrjen e masave dicyplinore ndaj tij/saj sipas nenit 84, pika 2 e kësaj rregulloreje.

### **Neni 40 Përgjegjësia individuale**

Një gjyqtarë duhet të jetë mirë i përgaditur me rregullat dhe rregulloret që i posedon sporti i Karatesë. Ai/ajo është përgjegjës për rrespektimin e rregullores së garave si dhe rregullores se komisionit të gjyqtarëve, çdo gjyqtarë/e bartë përgjegjësi individuale për veprimet tij/saj.

### **Neni 41 Respekti Reciprok**

Të gjithë gjyqtarët duhet të respektojnë mendimin e kolegëve, secili gjyqtar duhet të jetë në gjendje të shprehë mendimin e tij/saj pa frikë, tallje apo kritika nga të tjerët, i vetmi organ i cili është kompetent për të dhënë kritika gjyqtarëve është komisioni i gjyqtarëve. Gjithë të tjerët nuk janë kompetent dhe përgjegjës për këtë, dhe mos respektimi i këtij neni nga cilido gjyqtarë apo të tjerë individ pjesmarrës në një garë do të ketë për pasojë ndërmarrjen e masave dicyplinore ndaj tij/saj sipas nenit 82, pikat 1, 3, 4 dhe 7 të kësaj rregulloreje.

### **Neni 42 Shoqërimi gjatë garave**

Gjyqtarët nuk duhet të shoqërohen me garuesit, trajnerët dhe spektatorët gjatë zhvillimit të garës, ata/ato duhet të qëndrojnë diskret dhe profesional në mënyrë që të minimizohet mundësia e konfrontimeve apo paragjykimeve të ndryshme, dështimi për të shmangur shkeljen e këtij neni nga cilido gjyqtarë do të ketë për pasojë ndërmarrjen e masave dicyplinore ndaj tij/saj sipas nenit 82, pikat 1, 2, 3, 4 dhe 7 të kësaj rregulloreje.

### **Neni 43 Ballafaqimi**

Gjyqtarët nuk duhet të kenë ballafaqime apo konfrontime verbale me garuesit, trajnerët apo spektatorët. Nëse një gjyqtarë është përballur me një situatë të tillë, atëhere ai duhet të bëjë të gjitha përpjekjet për të shmangur atë dhe të drejtojë ankësën sipas procedurave të parapara

me rregulloret në fuqi dhe nëpërmjet organeve të duhura, mos respektimi i këtij neni nga cilido gjyqtarë do të ketë për pasojë ndërmarrjen e masave disiplinore ndaj tij/saj sipas nenit 82, pikat 1, 2, 3, 4 dhe 7 të kësaj rregulloreje.

#### **Neni 44**

##### **Konflikti i interesit**

Çdo gjyqtar duhet shmangur të gjitha rastet e konfliktit të interesit të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, dhe në çdo rast kur kjo shfaqet, menjëherë duhet të ndërmirren masat për eliminimin e konfliktit të interesit. Të gjithë gjyqtarët pa përjashtime, dhe në çdo formë, çdo kohë dhe çdo vend duhet të shmangin konfliktin e interesit, dhe për një gjë të tillë të informojnë menjëherë KGJ. Dështimi për të shmangur shkeljen e këtij neni nga cilido gjyqtar do të ketë për pasojë ndërmarrjen e masave disiplinore ndaj tij/saj sipas nenit 84, pika 2 e kësaj rregulloreje. Konflikt i interesit në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthort për gjyqtarët nënkuptohet për rastet si vijon:

1. *Shkelja rregullorës së konfliktit të interesit në FKK dhe WKF apo rregullat e tilla të ndonjë organizate – institucioni të cilin FKK dhe/ose WKF e njohin zyrtarisht;*
2. *Kur, një gjyqtar ndanë drejtësi për garuesit e klubit të tij/saj apo ndonjë anëtar të familjës së tij/saj;*
3. *Kur një gjyqtar në çfarëdo forme luan rolin e trajnerit dhe gjyqtarit në të njëjtën garë;*
4. *Kur një gjyqtar është anëtar i dy e më shumë klubeve të regjistruara në FKK, i njejt në këtë rast humb objektivitetin e tij si gjyqtar dhe nuk mund të ushtroj detyrën-funkisionin e gjyqtarit përderisa është anëtarë në dy e më shumë klube.*
5. *Gjyqtarët të cilët zhvillojnë aktivitete nëpër klubet në të cilët nuk janë anëtarë të rregullt dhe me nxënës të atyre klubeve të cilët janë garues dhe marrin pjesë nëpër gara.*

## **KREU V**

### **PËRZGJEDHJA DHE DELEGIMI I GJYQTARËVE**

#### **Neni 45**

##### **Kriteret e përgjithshme**

1. KGJ është kompetent të përzgjedhë apo delegoj gjyqtarët e FKK-s për pjesëmarrje në të gjitha aktivitetet shtetërore, rajonale dhe ndërkombëtare.
2. KGJ, do të përzgjedhë dhe delegoj gjyqtarët për pjesëmarrje në aktivitet e cekura në pikën 1 të këtij neni duke u bazuar në përmbushjen e kriterëve si në vijim:

**2.1 Kompetenca/Përgjegjshmëria** – një gjyqtarë duhet të shfaq interesim dhe seriozitet në lidhje me angazhimet dhe avancimet e tij/saj si gjyqtar.

**2.2 Nivelet e gradave shtetërore, rajonale dhe ndërkombëtare** – gjyqtarët të cilët posedojnë nivele dhe tituj më të lartë do të kenë përparësi;

**2.3 Eksperiencia** – gjyqtarët duhet të kenë përvojën e duhur në Sportin e Karatesë në përgjithësi dhe si gjyqtarë në veçanti.

**2.4 Pjesëmarrja në seminare dhe aktivitete tjera shtetërore** – gjyqtarët të cilët marrin pjesë dhe janë aktiv në aktivitetet shtetërore do të kenë përparësi të përzgjedhën.

**2.5 Mosha** – përparësi do të kenë gjyqtarët e moshës mesatare.

**2.6 Njohurit e gjuhëve të huaja – gjyqtarët të cilët kanë njohuri (shkrim-lexim-komunikim) të gjuhëve ose njërës gjuhë zyrtare të federatës botërore (WKF).**

## **2.7 Përformanca**

### **Neni 46**

#### **Kampionatet shtetërore dhe ngjarjet tjera në kuadër të FKK-së**

1. Gjyqtarët në kampionatet dhe turnet shtetëror duhet të jenë të certifikuar minimum me licenca, ndihmës gjyqtarë B në diciplinën Kumite dhe/ose gjyqtarë B në diciplinën Kata.
2. Komisioni i gjyqtarëve ka të drejtën e rezervuar, që në raste të veçanta të lejoj ose mos të lejoj që në një aktivitet zyrtar të mbajtur në Kosovë të ketë edhe gjyqtar që nuk posedojnë licencat të pranuar nga KGJ sipas nenit 29 të kësaj rregulloreje.

### **Neni 47**

Komisioni i gjyqtarëve për çdo garë që do të zhvillohet sipas kalendarit të FKK-së është i obliguar që t'i lajmëroj gjyqtarët e përzgjedhur më së voni 48 orë para fillimit të aktivitetit.

### **Neni 48**

Në garat zyrtare të Federatës të Karatesë së Kosovës dhe në ato ndërkombëtare përparsi për të qenë të deleguar për gjykim do të kenë gjyqtarët me licencat (gradat) më të larta dhe me eksperiencë më të madhe.

### **Neni 49**

Çdo gjyqtar i cili ftohet nga komisioni i gjyqtarëve për të ndarë drejtësinë në një aktivitet është i obliguar që të konfirmojë pjesëmarrjen ose mos pjesëmarrjen brenda 24 orëve pas njoftimit nga KGJ.

### **Neni 50**

#### **Përzgjedhja për garat dhe provimet ndërkombëtare**

1. Përzgjedhja e gjyqtarëve për garat e nivelit ndërkombëtar është përgjegjësi ekskluzive e komisionit të gjyqtarëve sipas nenit 25, pika 4, duke u bazuar në mundësitë buxhetore të FKK.
2. Komisioni i gjyqtarëve do të caktoj numrin e gjyqtarëve për garat ndërkombëtare sipas pikë 1 të këtij neni.
3. Komisioni i gjyqtarëve mund të delegoj gjyqtar në një garë ndërkombëtare edhe nëse nuk do të ketë garues, trajner dhe zyrtarë të tjerë pjesëmarrës nga FKK-ja.

### **Neni 51**

Përzgjedhja e gjyqtarëve për garat ndërkombëtare do të bëhet në bazë të kriterëve të përgjithshme sipas nenit 45, pikave 2.1, 2.2, 2.3, 2.4, 2.5, 2.6, 2.7 dhe sipas rregullave si në vijim:

1. Në bazë të rezultateve të arritura gjatë garave zyrtare në Kosovë.
2. KGJ, mund të aplikoj sistemin e rotacionit për pjesëmarrjen e gjyqtarëve në garat rajonale dhe ndërkombëtare dhe atë varësisht nga kriteret e parapara në nenin 45, pikat 2.1 deri në 2.7.

3. *Sjelljes dhe respektimit të Kodit të sjellje sipas Kreut VI të kësaj rregulloreje.*

#### **Neni 52**

Për ngjarje të tjera ndërkombëtare ose në rast të marrjes së ftesave nga ndonjë organizator i ndonjë turneu apo kampionati, gjyqtarët e ftuar duhet të kërkojnë leje nga komisioni i gjyqtarëve të Kosovës për të marrë pjesë në atë garë apo ngjarje. Dështimi për ta bërë këtë, ndaj çdo gjyqtari do të mirren masat dicyplinore nga KGJ sipas nenit 82 , pikat 1, 5, 6 dhe 7, dhe është nën diskresionin e KGJ të vendos për masat dicyplinore.

#### **Neni 53**

Nga gjyqtarët e përzgjedhur të cilët marrin pjesë në garat rajonale dhe/ose ndërkombëtare pritet të respektojnë kodin e sjelles sipas Kreut VI dhe rregullat si në vijim:

1. *Të jenë pjesë e ekipit shtetëror;*
2. *Të sillën si ambasadorë të Kosovës dhe ti përmbahen kodit të sjelljes;*
3. *Të ndihmoj trajnerin e ekipit shtetëror me çështje që ndërlidhen me rregullat e garave dhe gjyqtarisë në përgjithësi por jo gjatë garave dhe në objektet zyrtare të përcaktuara sipas organizatorit;*
4. *Të përpilojë një raport të veçant me shkrim për çështjet e gjyqtarisë nëse kërkohet nga komisioni i gjyqtarëve të Kosovës.*

### **KREU VII MEDITJET, PAGESAT DHE SHPËRBLIMET**

#### **Neni 54**

#### **Pagesat për komisionin e gjyqtarëve**

1. Për të gjitha aktivitet e organizuara nga komisioni i gjyqtarëve në kuadër të Federatës të Karatesë së Kosovës, komisionit të gjyqtarëve duhet t'i bëhet kompenzimi me të holla.
2. Komisioni i gjyqtarëve duhet të paguhet për të gjitha seminarët dhe provimet e mbajtura në kuadër të FKK-së.
3. Pagesat për komisionin e gjyqtarëve do të bëhen me shuma/meditje fikse për seminarët dhe provime të zhvilluara në kuadër të FKK-së.
4. Bordi Ekzekutiv do të merr vendim për pagesa/mëditje dhe tarifata tjera për gjyqtarët dhe komisionin e gjyqtarëve.
5. Vendimi i Bordit Ekzekutiv në lidhje me pagesa/mëditje dhe tarifata tjera për gjyqtarët dhe komisionin e gjyqtarëve do të jetë shktojçë e kësaj Rregulloreje.

#### **Neni 55**

#### **Shpërblimet/mirënjohjet**

1. KGJ, do t'i propozojë Komisionit për Përzgjedhje të Sportisit, Trajnerit, Punëtorit Sportiv dhe Gjyqtarit të Vitit që të shpërblej gjyqtarët meritor për të arriturat dhe përformimin e tyre në garat vendore, por jo edhe anëtarët e komisionit.
2. Shpërblimet/mirënjohjet ndahen nga FKK-ja të propozuara nga KGJ vetëm për gjyqtarët meritor dhe atë për:

2.1 Gjyqtari më i mirë i vitit;

2.2 Gjyqtar me perspektivë (gjyqtarët e rinjë).

3. Mirënjohje mund të ndahen në kuadër të KGJ-së edhe për gjyqëtarë për:

3.1 Arritje të rezultateve në nivel botëror; (ata të cilët marrin licencat e para WKF)

3.2 Arritje të rezultateve në nivel evropian; (ata të cilët marrin licencat e para EKF)

3.3 Arritje të rezultateve në nivel rajonal; (ata të cilët marrin licencat e para rajonale)

## **KREU VII RREGULLAT E PËRGGJITHSHME**

### **Neni 56**

Kandidatët duhet të jenë të pajisur me uniformë sipas dispozitave dhe rregullave të FKK-WKF.

### **Neni 57**

Gjyqtarët e deleguar për të ndarë drejtësinë në një ngjarje të organizuar nga FKK nuk mund të kryejnë edhe një funksion tjetër në atë ngjarje, në rast se gjyqtari ose gjyqtarët të cilët nuk e përfillin këtë nen do të ballafaqohen me masa disiplinore.

### **Neni 58**

KGJ, do të publikoj çdo vit listën zyrtare të gjyqtarëve të licencuar.

### **Neni 59**

KGJ duhet të ketë në dispozicion një hapësirë të vogël me kushte optimale të punës e cila duhet siguruar nga Bordi Ekzekutiv i FKK që të mbajë mbledhjet me anëtarët e saj për të diskutuar çështjet e gjyqtarisë.

### **Neni 60**

Takimet dhe aktivitetet e KGJ-s do të kordinohen nga vetë komisioni gjyqtarëve dhe do të publikohen, raportohen nga kryesuesi, në rast të mungesës së kryesuesit zëvendësimi do të bëhet nga njëri anëtar i komisionit.

## **KREU VII MASAT DICIPLINORE**

### **Neni 61**

Asnjë gjyqtarë pranë FKK-s i licencuar nga KGJ, duke përfshirë edhe komisionin e gjyqtarëve nuk gëzojnë imunitet ndaj shiptimit të masave disiplinore të parapara me këtë rregullore dhe statutin e FKK-së.

### **Neni 62**

KGJ, është autoriteti i cili inicon masa disiplinore ndaj gjyqtarëve bazuar në kërkesën e palëve të interesuara për shkeljet eventuale të kësaj rregulloreje, mos respektimin e rregullores së garave të WKF-së apo shkelje të statutit të FKK-së.

### **Neni 63**

Kryesuesi mund të kërkojë/largimin/shkarkimin e njërit nga anëtarët e komisionit, për shkeljet eventuale të kësaj rregulloreje, mos respektimin e rregullores së garave të WKF-s

apo shkelje të statutit të FKK-s. Për vendimin e marrë, Kryesesi njofton Bordin Ekzekutiv dhe dërgon emrin e anëtarit të ri të komisionit.

#### **Neni 64**

Bordi Ekzekutiv i FKK-së është i vetmi organ i cili mund të shkarkojë ndaj kryesuesit për shkelje të kësaj rregulloreje, mos respektimin e rregullores së garave të WKF-s apo shkelje të statutit të FKK-së. Komisioni Disiplinor është organi i vetëm i cili mund të ndërmerri masa disiplinore ndaj Kryesuesit për shkelje të rregullores së garave të WKF-së dhe Statutit të FKK-së.

#### **Neni 65**

Masat disiplinore shpëtohen në mënyrë individuale për çdo gjyqtar, të njëjtat nuk mund të kompenzohen nga ndonjë person apo gjyqtar tjetër.

#### **Neni 66**

##### **KGJ, ka komeptencë të shpitoj masat disiplinore si në vazhdim:**

1. *Me mos delegim të gjyqtarëve në garat vendore, rajonale dhe ndërkombëtare në periudhë kohore prej 1muaj deri në 3 muaj;*
2. *Me mos kompenzim të meditjeve të parapara me këtë rregullore si dhe me rregulloren për meditje dhe shpërblime e aprovuar nga bordi drejtues i FKK-s;*
3. *Me kompenzim të 50% të meditjeve të parapara me këtë rregullore si dhe me rregulloren për meditje dhe shpërblime e aprovuar nga bordi drejtues i FKK-s;*
4. *Me përjashtim nga një garë, seminarë dhe/apo provim shtetëror;*
5. *Suspendim nga funksioni i gjyqtarit në periudhë kohore sipas Rregullores së WKF. Suspendimi do të shqiptohet me vendim të Komsionit Disiplinor;*
6. *Mos delegim në provimet rajonale dhe ndërkombëtare;*
7. *Me pezullim të licencave prej 1 muaj deri në 12 muaj sipas Rregullores së WKF. Pezullimi do të shqiptohet me vendim të Komsionit Disiplinor;*
8. *Humbjen e të drejtës për shpërblime sipas nenit 55, pika 2 të kësaj rregulloreje në periudhë kohore prej 1 muaji deri në 12 muaj.*

#### **Neni 67**

1. Ndaj gjyqtarëve që marrin notën 1 në një garë për shkak të përformimit të dobët, do të shpëtohet masa disiplinore sipas nenit 66, pika 2 të kësaj rregulloreje.
2. Ndaj gjyqtarëve që marrin notën 1.5-2.0 në një garë për shkak të përformimit të dobët, do të shpëtohet masa disiplinore sipas nenit 66, pika 3 të kësaj rregulloreje.

#### **Neni 68**

1. Ndaj të gjithë gjyqtarëve të cilët shkelin nenet e parapara tek Kodi i sjelljes, Kreu VI përveç nenit 39 dhe 44 mund të ndërmerren masat disiplinore sipas nenit 66, pikave 1, 3 dhe 7.
2. Ndaj të gjithë gjyqtarëve të cilët shkelin nenet 39 dhe 44 të parapara tek Kodi i sjelljes, Kreu VI mund të ndërmerren masat disiplinore sipas nenit 66, pikave 2, 5, 6 dhe 7.

#### **Neni 69**

Ndaj gjyqtarëve të cilët bëjnë shkelje të rëndë, fyrije të rënda, sjellje dhe veprime qëllimkqija të cilat dëmtojnë prestigjin e Karatesë në përgjithësi dhe të FKK-s në veçanti KGJ do të ndërmerri masa disiplinore sipas Nenit 66, pika 5.

## **KREU VIII DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE**

### **Neni 70**

KGJ, detyrohet që të respektoj dhe zbatoj këtë rregullore në mënyrë të drejtë, të paanshme dhe profesionale.

### **Neni 71**

Bordi Ekzekutiv i FKK-s do të bëjë monitorimin dhe vlerësimin e zbatueshmërisë së kësaj rregulloreje nga ana e KGJ.

### **Neni 72**

Rregullorja për punën e komisionit të gjyqtarëve hyn në fuqi menjëherë pas aprovimit të bordit Ekzekutiv dhe nënshkrimit të kryetarit të FKK-s.

Kuptimi i terminologjisë dhe shkurtesave të përdorura në këtë rregullore:

FKK – Federata e Karatesë e Kosovës.

WKF – World Karate Federation.

EKF – European Karate Federation.

BKF – Balkan Karate Federation.

KGJ – Komisioni i gjyqtarëve.

AKGJ – Anëtari ose anëtarët e komisionit të gjyqtarëve.

Prishtinë, 19 qershor 2021

Ismet Krasniqi

  
Kryetar